

VENDIM
Nr. 149, datë 29.2.2012

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE PËR
PUNONJËSIT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 325, datë 28.5.2014; nr. 60, datë 27.1.2016; nr. 236, datë 2.5.2018; nr. 514,
datë 4.9.2018; nr. 881, datë 27.12.2022)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare jepen sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ku jepen elementet përbërëse, si më poshtë vijon:

a) Kategoria ose klasa për çdo funksion, kolona 2, e lidhjes nr. 1. Vlera mujore e pagës për çdo kategori dhe klasë është e njëjtë me vlerën e pagës për kategorinë dhe klasën, të përcaktuara me vendimin përkatës për nëpunësit civilë dhe për punonjësit mbështetës të administratës publike.

b) Paga e grupit, kolona 3, e lidhjes nr. 1, e cila përfitohet vetëm për nëpunësit me arsim të lartë universitar në funksionet e përcaktuara në këtë lidhje. Vlera mujore e pagës së grupit është e njëjtë me vlerën e pagës së grupit, e përcaktuar me vendimin përkatës për nëpunësit civilë.

c) Shtesa për vjetërsi në punë, kolona 4 e lidhjes nr. 1, jepet:

- në masën 2 për qind në muaj pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit për kategorinë e nëpunësve me arsim të lartë universitar;

- në masën 1 për qind në muaj pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën bazë për klasë për kategorinë e punonjësve me arsim të mesëm.

ç) Shtesa për natyrë të veçantë pune, kolona 5 e lidhjes nr. 1. Vlera mujore e saj jepet vetëm për funksionet e specifikuar në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2012, përballohen nga fondet e planifikuara për vitin 2012 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

3. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR. 1
STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE

(Shtuar funksioni “Zëvendësdrejtues” me VKM nr.325, datë 28.5.2014; ndryshuar lidhja nr.1 me VKM nr.60, datë 27.1.2016; ndryshuar me VKM nr.236, datë 2.5.2018; ndryshuar me VKM nr. 514, datë 4.9.2018; ndryshuar me VKM nr. 881, datë 27.12.2022)

Funksioni	Kategoria/klasa	Paga e grupit (lekë)	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë)
1	2	3	4	5
Titullar i institucionit	I-b	1	2%	
Drejtor drejtorie	III-a	1	2%	
Shef sektori	III-a/1	1	2%	
Specialist auditit, specialist në Kryeministri; specialist/redaktor ligjor në Kryeministri	III-b	1 ose 2 ose3	2%	
Sekretar (i titullarit dhe i bordit drejtues)	IV-b	1 ose 2 ose3	2%	7,000
Specialist finance, specialist kontabilist; specialist buxheti, specialist kosto, specialist i burimeve njerëzore; specialist jurist; specialist prokurimesh; specialist koncept – desing, specialist logjistike, specialist shërbimi; specialist trajtimi, specialist merceolog, specialist transporti, specialist shërbimi.	IV-a	1 ose 2 ose3	2%	
Specialist; specialist udhëtimesh; specialist protokoll /arkivi; specialist IT, specialist gjelbërimi, specialist inxhinier, sekretar për ish-presidentët.	IV-b	1 ose 2 ose3	2%	
Kryekuzhinier;	IX		1%	43,500
Kryepastiçier; kryekamerier; administrues Vila 4, Vila 30	IX		1%	17,800
Administrues vila/qendrash	IX		1%	12,700
Ndihmëspastiçier;	VIII		1%	12,700
Banakier	VIII		1%	9,300
Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare;	VIII		1%	7,300
Magazinier i magazinës qendrore;	VIII		1%	7,300
Kuzhinier rezidenca e Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VII		1%	17,800
Kuzhinier Vila Qeveritare;	VII		1%	12,700
Teknik elektrikist/hidraulik/mirëmbajtje/kameraman, fotograf/operator shumëfishimi në Kryeministri, shofer/korrier; shofer në Kryeministri, teknik të ndryshëm; punëtor në rezidenca qeveritare; kamerier; teknik dispeçer	VII		1%	7,300
Magazinier (magazinë dytësore)	VII		1%	7,300
Shofer	VI		1%	7,300
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor pastrimi, punëtor pastrimi në Kryeministri, punëtor lavanderie; punëtor gjelbërimi; roje/receptionist; roje magazina industriale; roje Pallati i Kongreseve, lavazhier,	IV		1%	7,300

Lidhja nr.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR DIPLOMAT E ARSIMIT UNIVERSITAR

(Shfuqizuar me VKM nr.60, datë 27.1.2016)

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS PËR ÇDO KATEGORI/KLASË

(Shfuqizuar me VKM nr.60, datë 27.1.2016)